



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks : 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



## ***BULETINI DITOR I FSSHM-së***

### ***PËRMBLEDHJE INFORMACIONESH NGA LËMIA E SHËNDETËSISË TË MARRA NGA SHTYPI DITOR DHE MEDIUMET ELEKTRONIKE***

***27 Janar 2016***



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks: 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



## Mjekët, letër publike ministrit të shëndetësisë dhe deputetëve

**Shkup, 26 janar** - Mjekët kanë dërguar një letër publike deri tek ministri i shëndetësisë Nikolla Todorov dhe deputetët e parlamentit të RM-së duke ju ankuar për punën e tyre. Ja çfarë shkruhet në letër.

"Të nderuar,

Në seancën publike që u mbajtë në Parlamentin e RM me rastin e ndryshimeve të reja në Ligjin për mbrojtje Shëndetësore, një grup mjekësh specializantë dhe specializantë të ardhshëm, shpalosën qëndrimin e tyre ndaj propozim ligjeve diskriminuese dhe të padrejta për specializim. Për fat të keq, edhe pse në në të shumtën e rasteve argumentet ishin në anën tonë, me 27 Janar (e mërkurë) është caktuar seansa plenare në Parlamentin e RM, ku në rend të ditës do jetë edhe plotësimi i ligjiit për shëndetësi me tekst KU ASNJË NGA KËRKËSAT TONA NUK ËSHTË MARRUR PARASYSH, të cilat që i parashtruar nëpërmjet Peticionit që u nënshkrua nga 350 mjekë.

Në vend të punësimit kohor të specijalizantëve privatë, ky ligj parasheh që çdonjëri nga specializantët privatë të punojnë 8 orë në ditë dhe një herë në javë 24 orë pandërprerë, të kryejë detyra të vendit të punës, bile dhe të gjobitet për thyerje të disiplinës në punë, ndërsa nga ana tjerër të mos paguhet as NJË DENAR RROGË, mos ketë sigurim pensional dhe shëndetësor, që përputhet dhe me nocionin e skllavopronarisë.

Në vend të kontratave 1:1 fer, ky ligj kërkon që çdo specializant i finansuar nga shteti të nënshkruajë kontratë të jovolitshme, represive dhe kërcënuese për lojalitet, sipas të cilit pas mbarimit të specializimit mjeku detyrohet të punojë 10 vite në shëndetësinë publike ose të paguajë gjobë gjer më 60.000 EUR. Mes 7 dhe 12 mijë euro është shumata e pagës për shkollim që shteti e investon për një specializant shtetëror, ndërsa çdo kthim i shumës është tepër më i lartë se shuma e investuar që përputhet dhe me definicionin e fajdes.

Me këtë zgjedhje ligjore thehen të drejtat tona si punëtorë dhe diskriminohemi në shumë baza. Në vend të menjanimit të testimit intermediar, moskalimi i tij do të jetë shkak për humbjen e të drejtës për të specializuar. Specializimi do të humbet edhe në rast të sëmundjes më afatgjate ose dy shtatzëni patologjike një pas një. Në vend të menjanimit, qëndron edhe video incizimi dhe emitimi live në internet gjatë kohës së testimit, me çka edhe poshtërsohet dhe degradohet mantili i bardhë.

Për të gjithë popullatën, tju përkujtojmë se, specializanti nuk është student, por mjek i licensuar dhe diplomuar i cili i pari e ka sanuar plagën e fëmiut tuaj, është mjeku që ka asistuar në operacionin tuaj për menjanim të tëmthit, është mjeku që ka reanimuar dhe restartuar zemrën e ndonjë të afërmi tuaj. Të ballafaquar me kushte brutale për specializim, dita ditës shtohet numri i atyre që janë të detyruar të dorëzohen nga ideja për



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks: 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



specializim dhe kjo gjendje në shëndetësi, në vend që ti mbajë ata, vetëm do ta stimulojë migrimin e tyre, që edhe ashtu është një fenomen global.

Ne, specialistët, që përbëjmë një nga shtyllat kryesore të sistemit shëndetësor, poqese vazhdojmë të qëndrojmë dhe arsimohemi nën këto kushte në Republikën e Maqedonisë, të përulur dhe diskriminuar në çdo hap dhe më një betejë të përhershme me probleme ekzistencialiste, kemi frikë se sa do jemi në gjendje që të ndërtojmë një system të fortë, stabil dhe të sigurt shëndetësor dhe para së gjithash frikësohemi për sigurinë e pacientëve në këtë sistem!

Publikisht e ftojmë Ministrin e Shëndetësisë dhe deputetëve të Parlamentit të RM edhe njëherë të konsiderojnë këtë çështje dhe të tregojnë vullnet të mirë për zgjidhjen e problemeve tona. I ftojmë të mendohen se çfarë sistemi shëndetësor ndërtojnë dhe si në të i trajtojnë specialistët si bartës të shëndetësisë sekondare dhe terciare. Asnjëherë nuk është vonë për vendime të drejta. Apelojmë për asgjë më tepër, e asgjë më pak se atë që e meritojmë – kushte fer dhe korrekte për punë dhe edukim dhe burim ekzistence në ato vite kur na duhen më tepër, në vitet që tërësisht përkushtohemi dhe profesionalisht i qasemi shëndetit të pacientit tonë. Të bëhemi shtet për shembull, shtet që do e zgjedhe problemin e migrimit të mjekëve.

Me respekt, Mjekët specijalizant dhe specijalizantët e ardhshëm,

Pranë Fakultetit të Mjeksisë- UKIM

## Shumë pak femra vizitojnë gjinekologun, 11% e tyre bëjnë pap test

**Shkup, 26 janar** – Edhe pse mund që të shërohet me kohë nëse zbulohet, kanceri në qafë të mitrës është një nga shkaqet kryesore për vdekjen tek femrat në Maqedoni, njofton Zhurnal.

Nga kjo sëmundje vdekjeprurëse në Maqedoni në nivel vjetor vuajnë mbi 250 femra a vdesin më së paku 30 prej tyre. Edhe pse vetëdija tashmë ka nisur të rritet dhe me programe të ndryshme mundohet që femrave t'iu bëhet me dije që duhet të kontrollohen, 11% e tyre kryejnë kontrolle tek gjinekologu ndërsa shumë pak kryejnë edhe pap test.

Edhe përkundër asaj se organizohen shpesh kontrolle falas, duket se lufta kundër kancerit në qafën e mitrës po humbet, ndërsa nga ajo që shohim çdo ditë nëpër ordianca që gratë presin rradhë, gjinekologët e komentojnë ndryshe.

“Nuk do thoja se e humbim luftën kundër kancerit në qafën e mitrës. Nëse themi ashtu do duhet të pranojmë se që nga fillimi kemi humbur. Megjithatë secili gjinekolog ka fuqinë e tij, njohuritë dhe diagnostifikimet, me kontrolle të ndryshme dhe terapi mund të tejkalohet kriza”, thekson kështu Boban Sarxhovski, gjinekolog.



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks : 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



## Viruset mbushin spitalet

**Shkup, 26 janar** – Për vetëm një javë nga infektimet e viruseve janë sëmurë 16.156 pacient, tregojnë kështu nga Instituti i shëndetit publik.

Infeksionet virusale kanë mbushur spitalet. Thujse nuk ka familje në vend që nuk ka një të sëmurë në shtëpi. Mjekët thonë se ndryshimi i kohës dhe temperaturave prej 20 gradë dallim për vetëm një javë është një shok për organizmin e njeriut me cka ndikojnë në shpërndarjen e viruseve. Me dhjetra pacient ankohen për temperaturë, rrjedhje të hundës, kollitje si dhe dhimbje barku, njofton Zhurnal.

Mjekët pediatër rekomandojnë se tek fëmijët duhet të ketë shumë kujdes vecanërisht ato që shkojnë në cerdhe dhe shkolla, madje rekomandohet që ato që janë të sëmurë të rinë në shtëpi e mos shkojnë shkak që virusi mos transmetohet tek të tjerët.

## Gjermania është vend i ëndrrave për mjekët nga Maqedonia

**Shkup, 26 janar**- Gjuha gjermane edhe më andej po ngel si sfida kryesore e mjekëve nga Maqedonia, ndërsa Gjermania vendi i tyre i ëndrrave. Me mbizotërimin e mirë të gjuhës ata mund të gjejnë punë në këtë shtet dhe për këtë të marrin paga më të larta se këtu, transmeton zhurnal.mk

Gjatë vitit 2015, Oda e mjekëve ka dhënë 170 vërtetime me rekomandime me të cilat mjekët ikin në punë, specializime dhe ri aftësime jashtë vendit. Në mënyrë shtesë disa po shkojnë edhe pa marr vërtetime dhe pastaj në mënyra të ndryshme po tentojnë që të ngelin jashtë vendit.

Përveç Gjermanisë, për mjekët interesante janë edhe Zvicra dhe vendet skandinave. Praktikisht migrimi botëror i mjekëve nuk e përfshin vetëm Maqedoninë.

Shkollat për gjuhë të huaja tashmë në reklama të veçanta po i theksojnë kushtet që i japin për mjekët që duan të aplikojnë për punë në Gjermani dhe për të cilën ata mund të japin provimin B2 dhe C1. Pjesa dërmuese e tyre tashmë e mësuan gjuhën dhe ikën. Ndërsa për shkak të interesit, njëkohësisht po ofrohen edhe shërbime për ndërmjetësim për punë.



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks : 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



## Mjekët-specializant ankohen se u janë shkelur të drejtat e punëtorit



Me propozim ndryshimet e reja, në ligjin për mbrojtje shëndetësore janë shkelur të drejtat tona të punëtorëve dhe jemi të diskriminuar thonë një pjesë e specialistëve të ri. Në prag të mbledhjes së nesërme të Kuvendit ku në rend dite do të jetë plotësimi i ligjit për mbrojtje shëndetësore, specialistët apelojnë të merren parasysh kërkesat e tyre. Ata dorëzuan peticion në Kuvend, të cilën e mbështetën 350 mjek të ri. Ata ankohen se punojnë 8 orë me orar të plotë dhe një herë në javë kanë kujdestari 24 orëshe, pandërprerë, për çka nuk marrin asnjë denarë.

“Ne nuk kërkojmë as më pak e as më shumë se sa që e meritojmë e ajo është zgjidhja e statusit të specialistëve. Për specialistët privat kompensim në para, ndërsa për ato shtetëror zgjidhje e kambialit që është nënshkruar”, tha Aleksandar Milosavljeviq- specialist në klinikën e kardiologjisë.

Specializantët ankohen edhe për ndryshimet me të cilat humb specializimi në rast të pushimit më të gjatë mjekësor, ose dy shtatzëni patologjike njëra pas tjetrës. Ata kërkojnë edhe anulimin e video regjistrimit të provimeve që planifikohet të transmetohet në internet.

## Qytetarët preken nga virusi i stomakut, shkak temperaturat e ndryshueshme



Një virus jo tipik stomaku për këtë periudhë të vitit po i krijon probleme qytetarëve. Ambulancat në kryeqytet po mbushen me pacientë të cilët kërkojnë ndihmë për shkak të dhimbjeve në stomak, por edhe viruseve që shkaktojnë simptoma të ftohjes. Mjekët thonë se viruset e stomakut



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks: 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



nuk janë tipike për këtë periudhë të dimrit dhe me siguri janë si pasojë e kushteve aktuale të motit.

"Ka viruse, ka viruse stomaku me diarre, me temperatura dhe viruse që nuk janë grip, por janë si ftohje, me kollitje dhe temperaturë. Moti nuk është ashtu siç duhet të jetë në dimër. Kishim temperatura të larta si në periudhën pranverë-verë, që kontribuojnë në paraqitjen e këtyre viruseve, pastaj kishte temperatura shumë të ulëta dhe mendoj se kjo është arsyeja", deklaroi Novica Mitanovska, Poliklinika Bit Pazar.

Gripi që në këtë periudhë ka marr hov është aktual në Tetovë, Kumanovë dhe Prilep. Mjekët këshillojnë qytetarët të cilët ballafaqohen me viruset e stomakut t'i përmbahen dietës. Po ashtu këshillohen qytetarët të mbajnë higjienën personale, të lëvizin në vende ku ka ajër të pastër, të pinë shumë lëngje, të konsumojnë ushqim të shëndetshëm dhe vitamina të cilët do ta përforcojnë imunitetin e tyre.



## Mjekët-specializant ankohen se u janë shkelur të drejtat e punëtorit



Me propozim ndryshimet e reja, në ligjin për mbrojtje shëndetësore janë shkelur të drejtat tona të punëtorëve dhe jemi të diskriminuar thonë një pjesë e specializantëve të ri. Në prag të mbledhjes së nesërme të Kuvendit ku në rend dite do të jetë plotësimi i ligjit për mbrojtje shëndetësore, specializantët apelojnë të merren parasysh kërkesat e tyre. Ata dorëzuan peticion në Kuvend, të cilën e mbështetën 350 mjek të ri. Ata ankohen se punojnë 8 orë me orar të plotë dhe një herë në javë kanë kujdestari 24 orëshe, pandërprerë, për çka nuk marrin asnjë denarë.

"Ne nuk kërkojmë as më pak e as më shumë se sa që e meritojmë e ajo është zgjidhja e statusit të specializantëve. Për specializantët privat kompensim në para, ndërsa për ato shtetëror zgjidhje e kambialit që është nënshkruar", tha Aleksandar Milosavljeviq- specializant në klinikën e kardiologjisë.

Specializantët ankohen edhe për ndryshimet me të cilat humb specializimi në rast të pushimit më të gjatë mjekësor, ose dy shtatzëni patologjike njëra pas tjetrës. Ata kërkojnë edhe anulimin e video regjistrimit të provimeve që planifikohet të transmetohet në internet.